

verë 2025

Living

BIG BASTIA

VESA LUMA



“JEMI DHE S'JEMI!”

BIG BASTA VESA LUMA



Pas një mungese të gjatë në skenë, jetën kulturore shqiptare dhe televizion, Big Basta e Vesa Luma janë rikthyer më në fund “me kohë të plotë”. Big Basta sapo është larguar madje me trofeun e edicionit të dytë të “Ferma VIP” në Vizion Plus, një shenjë se “kanë ende shumë për të dhënë e për të bërë”. Midis muzikës e spektaklit. Prindërimit e karrierës. Thashethemeve dhe dashurisë. Botës dhe Shqipërisë. **Big Basta e Vesa Luma “janë dhe s’janë”...**

Nga **Gentian Minga**
Fotograf: **Geljant Kaleci**
Redaktore: **Etleva Çepele**
Grimi & flokët: **Suela Cangu**
Dizajni: **Emi Kokushta**





“HEEEEEEEJ, NE JEMI GATI!”

Po i prisnim Vesën e Big Bastën në set me fotografimin Geljant Kaleci, grimieren Suela Çangu dhe ekipin e Living Room, në Vizion Plus. Ky do të jetë një set special për çiftin e artistëve. **“Është hera e parë që bëjmë një shërbim fotografik për një revistë me djalin. Jemi shumë të emocionuar”**, thotë Vesa dhe në portretin vizatohet ajo buzëqeshja karakteristike. Kështu e mbaj mend që në fillimet e saj, tek “Ethet e së premtës”. Edicioni që u transmetua në Vizion Plus. “Kur shkova të firmos kontratën për pjesëmarrjen në “Ferma VIP” u habita që të gjithë njerëzit që mbaja mend para disa dekadash ishin ende aty”, thotë Big Basta dhe Vesa konfirmon me një tundje të lehtë të kokës.

» Këto lajme kurrë nuk na kanë shqetësuar, madje i kemi lexuar me Vesën dhe kemi qeshur. **Por në këtë rast ishte ndryshe...** «





Janë të njëjtit njerëz që mban mend edhe ajo. Historia e të dyve, veç e veç por edhe së bashku, është ngushtësisht e lidhur me këtë ekran. Vesa e pati debutimin tek “Ethet”, pikërisht sezoni që u realizua në Vizion Plus. Po aty u njohën dhe u dashuruan, kur ishin të dy konkurrentë në “Dancing with the stars”, një tjetër produksion i Vizion-it. Ajo që nisi si konkurrencë do të shndërroj dalëngadalë në miqësi dhe mandej në një dashuri, e cila zgjat prej katërbëdhjetë vitesh. E ja ku jeta i solli sërish në ekranin kumbar të dashurisë së tyre, këtë herë në një reality show si “Ferma VIP”, nga ku Big Basta do të largohet fitimtar dhe me njëqind mijë euro në xhep.

“VIZION PLUS NA KA SJELLE PËRHERË FAT”



Brenda pak minutave do të kalonim nga “Si do t’ia bëjmë me Lianin, se i urren fotot” te “Liani qenka model i lindur!” Për Vesën kjo është diçka e re, sepse i biri gjithmonë i eviton fotografitë. Ama sot, fatmirësisht, po ndjehet i përfshirë. “Falë këtij seti zbulova se Liani është miks i të dyve. Ndonjëherë jemi ekstrovertë, ndonjëherë introvertë dhe Liani, si shenja e Binjakëve që është, ka dalë miks i këtyre dy poleve”, thotë Vesa.

“Gjatë këtij shërbimi fotografik po zbuloj se vërtet Liani mund të mos i ketë qejf fotot, por kur e kupton se është një punë për t’u kryer, impenjohet dhe e çon deri në fund.”

Po e shijojnë këtë set, si diçka që po e bëjnë të tre bashkë, gjë për të cilën i kishte marrë malli këto kohë që Big Basta ishte i izoluar. Për rreth tre muaj kanë qenë të ndarë, ndaj që nga dita që Geri përfundoi aventurën e “Ferma VIP” nuk janë larguar asnjë sekondë nga njëri-tjetri. Bënë një udhëtim të gjatë nëpër Shqipëri, nga Thethi në jug, pastaj shkuan në Greqi, ku Geri festoi ditëlindjen. “Gëzuar përvjetorin”, e uroj, por ai mbushi 39 vjeç, jo 40, siç raportuan portalet. “Nuk është hera e parë që ia fusin kot”, thotë Big Basta.

Ku ka zë, ndonjëherë është pa gjë. I kam lexuar, njësoj si ju, artikujt ku thuhet se Vesa nuk donte që Big Basta të hynte në “Ferma VIP”, çka u bë mollë sherri mes çiftit. Deri në pikën që flitej për ndarje. “Lajmi është zmadhuar, por një pikënisje e ka. Duke e njohur Gerin dhe duke parë si funksionojnë reality show-t, e mendoja të vështirë që një tip si ai t’i përballonte situatat që ndodhin në këto lloj formatesh. Ky ishte merak im, të cilin ndoshta ia kam shprehur dikujt në mirëbesim dhe pastaj kjo është

“Nuk e kemi menduar kurrë ndarjen!”

përcjellë e transformuar rrugës. Por nuk e kam diskutuar kurrë seriozisht këtë shqetësim me Gerin, sepse nuk i jemi përzier kurrë njëri-tjetrit në vendime kaq personale apo që kanë të bëjnë me karrierën”, thotë Vesa. “Çfarëdo që ai të vendosë do ta mbështes, siç kam bërë edhe në këtë rast.” Nuk është hera e parë që mediat flasin për probleme e krizë mes çiftit, madje ndarje. Edhe atëherë kur Big Basta u zhvendos në Zelandën e Re, mediat shkruan për një krizë. E njëjta gjë kur u kthyen nga Zelanda e Re dhe u vendosën sërish në Tiranë.

Çdo lëvizje është shoqëruar me thashethemin e ndarjes. “Ngaqë jeta jonë ka qenë dinamike, kemi pasur ndryshime drastike e shumë lëvizje, gazetarët kanë aluduar. Pak edhe nga nevoja për material dhe lajme”, thotë Big Basta, që nuk duket i mërziur. “Këto lajme kurrë nuk na kanë shqetësuar, madje i kemi lexuar me Vesën dhe kemi qeshur. Por në këtë rast ishte ndryshe. Lajmin e lexova dy ditë para se të niste “Ferma VIP” dhe nuk më bëri mirë për gjendjen shpirtërore me të cilën po hyja në lojë.” Geri do të kishte preferuar ta kishte nisur këtë përvojë në rrethana të tjera, megjithatë nuk e lejoi këtë moment të pakëndshëm të ndikonte në rrugëtimin e tij.

Nga ana tjetër, përfolja mund të ketë të mirat e saj, sepse të vendos në qendër të vëmendjes dhe kjo të bën mirë në një format si “Ferma VIP”. “Nuk jam shumë i sigurt për këtë, është thikë me dy presa, ndaj nuk e kam parë si strategji loje. Por ndoshta dashur pa dashur, ky lajm u kthye në favorin tim”, pranon Big Basta. “Kjo temë filloi të përflitej edhe në “Ferma VIP”, pasi lajmin e kishin lexuar edhe konkurrentët e tjerë dhe ata u përpoqën ta përdornin si strategji për të më sulmuar e nxjerrë nga vetja. Por unë i kisha idetë e qarta. Prisja ditëlindjen e Vesës, që të publikoja këngën dedikuar asaj. Ky për mua do të ishte momenti i duhur për t’u mbyllur gojët e liga.”

»» Në 14 vjet lidhje nuk kemi pasur kurrë ndonjë zënkë serioze apo të mendojmë ndarjen. Grindje të vogla në përditshmëri, si çdo çift, por asnjëherë kriza të mëdha. ««



Përpara se të futen në “Ferma VIP”, të gjithë kokurrentët kalojnë një natë të izoluar në hotel. Pikërisht një ditë përpara se Geri të ndahej me Vesën dhe Lianin e të nisej për në hotel, ishte ditë Bajrami. Teksa largohej me makinë, i biri e ndoqi mbrapa me vrap dhe i dhuroi një lule. Kjo e bëri Big Bastën t’i mbushen sytë me lotë. Dhe jo vetëm atë. **“Ngriva nga kjo skenë e për një çast ndjeva trishtim. Kuptova se për disa kohë nuk do të kishim asnjë komunikim, kjo më shkaktoi një ndjesi të çuditshme”**, kujton Vesa. Ishte momenti i parë që u ndërjegjësua se nuk do të fliste me Gerin për disa muaj. Ishte hera e parë që ndaheshin plotësisht.

“Kemi qenë edhe herë të tjera larg njëri-tjetrit për pak kohë, siç ishte rasti i Zelandës së Re”, thotë ajo. “Por ndonëse jemi ndarë fizikisht, kemi qenë non-stop në telefon. Ideja që kësaj here as telefonatat nuk do t’i kishin më shtiu ankthin.”

Aq i vështirë sa ishte momenti i fundit bashkë para izolimit në “Ferma VIP”, po aq magjik ishte nata e parë pas daljes së Gerit, si fitimtar, nga ky format. Ishin aq të përmallur e kishin kaq shumë gjëra për të thënë, sa ndejtën të tre zgjuar, duke folur, deri në katër të mëngjesit. Pastaj Lianin e zuri gjumi dhe çifti e gdhui deri në gjashtë të mëngjesit. Vesa i tregoi gjithçka që nuk kishte pasur mundësi ta mësonte teksa ishte në “Ferma

VIP”; reagimet e të njohurve e të panjohurve, lajmet dhe videot që qarkullonin. **Por gjëja më e vështirë që Vesës iu desh të bënte ishte t’i jepte Big Bastës lajmin e dhimbshëm të ndarjes nga jeta të gjyshes së tij.** Ajo kishte qenë shumë sëmure përpara se Geri të futej në “Ferma VIP” dhe kishte ndërruar jetë pak ditë përpara finales së “Ferma VIP”. Prindërit vendosën të mos ia jepnin lajmin atij teksa ishte në fermë dhe t’i lejonin ta çonte garën deri në fund. Nuk kishte qenë një vendim i lehtë. Pyetja e parë që Big Basta i bëri Vesës teksa linin parkimin e Vizion Plus-it ishte “Si osht nona?” Përgjigjja e pashmangshme e bëri të derdhte lotë.

Sipas Vesës, një ngjarje që ndoshta “i ushquu” më tej këto “gojë të liga” ka qenë ajo kur moderatorja e “Ferma VIP”, Luana Vjollca, pyeti Gerin se për kë do ta merrte malli më shumë pasi të futej në fermë dhe ai u përgjigj “për djalin dhe familjen”. “Gazetarët ngritën pikëpyetje se përse Geri nuk më përmendi”, thotë Vesa, teksa Big Basta përgjigjet, po me një pyetje. “A nuk është Vesa familja ime?” Asnjë nga lajmet për ndonjë krizë apo ndarje të mundshme nuk ka qenë i vërtetë. “Në 14 vjet lidhje nuk kemi pasur kurrë ndonjë zënkë serioze apo të mendojmë ndarjen. Grindje të vogla në përditshmëri, si çdo çift, por asnjëherë kriza të mëdha”, thotë Vesa.

LIVING
PERSONAZH

NDARJA, RIBASHKIMI DHE NJË HUMBJE E MADHE

“Na ka bërë përshtypje mënyra se si reagoi Liani pasi pa të atin duke qarë”, kujton Vesa. “‘Mendo tre gjëra pozitive nga kjo gjë...’, i tha ai të atit, si të ishte një i rritur. ‘E para, gjyshja ka vuajtur shumë dhe tani shpëtoi. E dyta, edhe prindërit e tu janë të lirë, sepse edhe ata kanë vuajtur bashkë me gjyshen. E treta, mendo se ke një engjëll atje lartë që të sheh e të mbron.’ Kemi mbetur pa fjalë.

“Kuptova se tashmë Geri nuk ka më thjesht një djalë, por një shok.”

LIVING.AL

Megjithatë, ajo vendosi të mos reagoje as këtë herë. Ose, veçanërisht këtë herë. Zgjodhi të rrinte në hije gjatë gjithë kohës që Big Basta ishte në “Ferma VIP”, përveç momentit të surprizës përgatitur nga produktioni, ku ishte e ftuar. “Ferma VIP” ishte momenti që Geri të tregonte veten. Ne, pavarësisht se kemi karrierat dhe rrugët e ndara artistike, shumë gjëra i kemi bërë bashkë. Unë kam pasur mundësi të tregoj më tepër nga vetja, kam dhënë më shumë intervista, ndaj kësaj here do të ishe mirë që gjithë prozhektorët të ktheheshin nga Geri. Jo se është bashkëshorti im, por e vërteta është se në “Ferma VIP”, tek ai publiku ka mundur të shikojë një tjetër shembull të maskullit shqiptar. E nëse unë do të përfshihesha më shumë se ç’duhej, ndoshta do të prishja punë”, shpjegon Vesa.



» Për konkurrentët isha thjesht një i pashkollë, ashtu donin të besonin. Kjo gjë më kaloi në avantazh, sepse nënvlerësimi rezultoi se ishte në favorin tim. «

MOMENTI KUR DOJA TË DILJA NGA “FERMA VIP”

Pavarësisht mallit për familjen, djalin, muzikën, pavarësisht sherreve e debateve dhe trysnisë që vjen prej izolimit, Big Basta ia doli të çojë në shtëpi trofeun e edicionit të dytë të “Ferma VIP”. Pak a shumë, strategjia e tij, sipas vetë fjalëve të Big Bastës, ishte të qëndronte i heshtur javët e para, sa t’i blinte të gjithë dhe t’i bënte ta nënvlerësonin e mos ta shikonin si të rrezikshëm, pastaj nga fundi të futej fuqishëm në lojë. Gjithçka e përllogaritur. Edhe pse qëndrimi në shtëpi dhe përplasjet ishin një trysni e madhe, Big Basta kurrë nuk e ka menduar të heqë dorë nga “Ferma VIP”, përveç një momenti delikat, që i kujtohet si të ishte dije: “Ka qenë pak ditë para ditëlindjes së Lianit. Më bënte të ndjehesha keq ideja që, për herë të parë nuk do të isha aty për ta uruar dhe për të festuar bashkë me të”, kujton Big Basta.

Sa iu përket përplasjeve dhe debateve me fermerët e tjerë, sipas tij, e ashuquajtura “lufta e nervave” ishte shpikur nga disa prej tyre si strategji loje, por që “me të nuk piu ujë”. “Nuk e dinin se në fakt, unë isha në habitatin tim, sepse kam studiuar për sociologji dhe “Fermën VIP” e shikoja thjesht si një eksperiment social. Pastaj, të mos harrojmë se kam bërë atë që njihet si “rrepi social”, thotë Big Basta. **“Iu këndoj fenomeneve sociale, siç disa prej atyre që ndodhnin në shtëpinë e “Ferma VIP” dhe për mua si artist, situatat aty ishin një ushqim, jo stres. Por për konkurrentët isha thjesht një i pashkollë, ashtu donin të besonin. Kjo gjë më kaloi në avantazh, sepse nënvlerësimi rezultoi se ishte në favorin tim.”**

GERI REPERI VS. GERI KAVALIERI

Një nga meraqet kur je 24/7 i vëzhguar nga kamerat është se si do të dukesh te publiku. Për Vesën, mënyra se si Geri është shfaqur ka qenë tepër pozitive. Ka qenë vetvetja, i natyrshëm dhe siç është në përditshmëri. Qoftë kur lëvizte nëpër shtëpi për të bërë ndonjë punë, qoftë kur sillej si xhentëllmen me vajzat. I ka pëlqyer sidomos kur Big Basta përkujdesej për Elinarën në momentet që ajo ndjehej vetëm në shtëpi. “Geri është po ashtu i fiksuar pas pastërtisë, gjë që u vu re edhe në “Ferma VIP”. Jam e kënaqur që edhe të tjerët tanimë e njohën këtë anë të tij”, thotë Vesa. Anën e tij të butë, sidomos me femrat, Big Basta e ka prej motrës dhe së ëmës. U është mirënjohës që e mbrujtën me mirësjelljen dhe respektin ndaj vajzave. Që të jetë i afërt dhe i hapur për t’i dëgjuar. Kjo madje e ka ndihmuar të kishte sukses me Vesën e t’i fitonte zemrën në fillimet e tyre. “Kur ishim në ‘Dancing with the stars’, Geri hyri në muhabet me mua.



Unë kisha hallet e mia, se jo nuk isha e kënaqur me balerinin, pastaj konkurrenca, plus jetoja larg shtëpisë, në hotel dhe isha e ngarkuar emocionalisht. Një ditë më pyeti si ia kaloja dhe i thashë, ‘Mirë, por na lodhi dieta.’ Se ngaqë duhet të ruanim linjat hanim vetëm sallata dhe fileto pule. ‘Na ka marrë malli për groshë’, i thashë dhe të nesërmen Geri më solli grosh të gatuar nga mami i tij. U shkruva komplet”, kujton Vesa mes të qeshurave.

NË SHTATOR, NJË PROJEKT TELEVIZIV BASHKË

“Do të të bëj një pyetje alla shqiptarçe”, i them Gerit për ta përgatitur. “Do të më pyesësh sa e kam rrogën, me siguri”, thotë ai, por jo, kjo nuk ka ndonjë vlerë të madhe, pasi dihet që sapo ka fituar njëqind mijë euro nga “Ferma VIP”. Në fakt, kureshtja ime është nëse ai dhe Vesa kanë menduar t’i bëjnë Lianit një vëlla apo motër. Përgjigjet ishin tepër interesante për të mos u përfshirë në shkrim.

“Sa më përket mua, herë jam 50% me 50%, herë 100% (e dua patjetër një fëmijë) dhe herë të tjera 0% (pra nuk e dua). Në këtë moment jemi rehatuar dhe nuk dua ndryshime të mëdha. Kemi pasur një jetë intensive, gjithmonë në lëvizje e për herë të parë pas shumë kohësh, e kemi marrë pak shtruar dhe po shijojmë jetën”, thotë Vesa, e cila shton se hezitimi i vjen ndoshta edhe ngase si nënë ndjehet e përmbushur. **“Kam pasur fatin ta rris vetë Lianin, ta shijoj çdo moment me të, ndaj si nënë nuk kam pengje. Dhe sinqerisht nuk e di a do të kisha po kaq energji sa me Lianin për të rritur një fëmijë tjetër.”**

Edhe Big Basta bie dakord me bashkëshërren e tij, Vesën, dhe pranon se ky është momenti për të shijuar jetën e për ta marrë shtruar, pasi për shumë vite jeta e tyre ka qenë një aventurë e gjatë dhe e çmendur. Por, ndryshe nga Vesa, Geri e ka me më tepër qejf të bëjë një fëmijë tjetër. “Dhe do ta doja gocë”, shton. Gjë që për Vesën nuk do të ishte problem, pasi është rritur në një familje vetëm me vajza: ajo, mami dhe dy motrat. Kështu që, do ta rriste një gocë me sy mbyllur. Kurse të qenit nëna e një djali ka qenë ndryshe. “Më ka bërë shumë mirë”, thotë. “Jam rritur bashkë me Lianin. Madje mund të them se kam mësuar më shumë unë prej tij se sa ai prej meje.”



» Kam pasur fatin ta rris vetë Lianin, ta shijoj çdo moment me të, ndaj si nënë nuk kam pengje. **Dhe sinqerisht nuk e di a do të kisha po kaq energji sa me Lianin për të rritur një fëmijë tjetër.** «

Edhe Big Basta bie dakord me bashkëshërren e tij, Vesën, dhe pranon se ky është momenti për të shijuar jetën e për ta marrë shtruar, pasi për shumë vite jeta e tyre ka qenë një aventurë e gjatë dhe e çmendur. Por, ndryshe nga Vesa, Geri e ka me më tepër qejf të bëjë një fëmijë tjetër. “Dhe do ta doja gocë”, shton. Gjë që për Vesën nuk do të ishte problem, pasi është rritur në një familje vetëm me vajza: ajo, mami dhe dy motrat. Kështu që, do ta rriste një gocë me sy mbyllur. Kurse të qenit nëna e një djali ka qenë ndryshe. “Më ka bërë shumë mirë”, thotë. **“Jam rritur bashkë me Lianin. Madje mund të them se kam mësuar më shumë unë prej tij se sa ai prej meje.”**

Tashmë çifti i artistëve është përqendruar të ndërtimi i shtëpisë së re, ku janë futur prej pak kohësh, si edhe te karriera. Një nga gjërat më të bukura të fitores së Gerit është vibe-i që ka sjellë te Vesa. Kjo sfidë e Big Bastës e ka frymëzuar atë. “Ishte një shenjë se kemi ende mundësi të bëjmë gjëra të mëdha në jetën e karrierën tonë”, shpjegon. “Qëllimi që Geri i vuri vetes e këmbëngulja për t’i shkuar kësaj sfide deri në fund më ka ndryshuar komplet qasjen për gjërat. Rikthimi nga Zelanda e Re nuk ka qenë i lehtë, pasi edhe në rrethet tona kemi dëgjuar nga kolegët fjalë jo fort inkurajuese, të tipit ‘pse u kthyet, çfarë mund të bëni ju këtu tani, etj. Por Geri tregoi se nuk ka rëndësi sa gjatë largohesh nga skena publike, gjithmonë mund të bësh gjëra të mëdha.” Edhe pse gjatë kësaj kohe Vesa është marrë më tepër me projektet personale dhe i ka lënë hapësirë rrugëtimit të Big Bastës në “Ferma VIP”, nuk harron se të dy bashkë janë të pathyeshëm. Janë “mbinatyralë”. Dhe jo vetëm në muzikë. Ndoshta ngase ndjehen të relaksuar pas kësaj bisede të gjatë që ngjan më tepër si një rrëfim mes miqsh, çiftit i shpëton një lajm, të cilin në rrethana të tjera ndoshta do ta kishin ruajtur nga gazetarët. Planet për një program televiziv së bashku. “Ku? Si? Qysh? Tek?” Pyetje. Kureshtje. Këmbëngulje. “Eh, nuk mund të themi më shumë se kaq, madje edhe kaq shumë ishte”, i vë Vesa kapakun bisedës e me këtë rast, edhe kësaj dite të bukur, por të gjatë e të lodhshme në botën magjike të Meliá Resort në San Pietro.

